



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:015871

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428238

C.nr.510/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtorin profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditëses M.J. nga V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B., avokat në P., kundër të paditurës Komuna P. -Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 816 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.J. nga V., **detyrohet** e paditura, Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, për 408 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 12.03.2020 deri më 21.11.2022, në emër të shpenzimeve të ushqimit, t'ia paguajë shumën **816 €**, me kamatë ligjore 8 % e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me datë 16.01.2024 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia kompensojë shumën 125 €, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 16.01.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, me vlerë të kontestit 816 €.

Në padi, ka theksuar se paditësja është e punësuar në shkollën fillore "N.P." në fshatin R., Komuna V., e cila për periudhën nga data 12.03.2020 deri më 21.11.2022, ka 408 ditë pune ndërsa e paditura nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit siç parashihet në Kontratën kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t 2017 dhe 2021 prandaj, gjykatës i ka propozuar që të detyrohet e paditura, në emër të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguajë shumën 816.00 €, me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së padisë si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Për të mbështetur pretendimet si në padi, si prova ka propozuar: Vërtetimin e punës nr. 119, të datës 08.11.2023; Kontratën e punës nr. 05-265/2013, të datës 01.09.2013 dhe Listën e pagave EM00019103.

Numri i lëndës: 2024:015871
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05428238

E paditura, përmes përgjigjes në padi, ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet që dalin nga KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror e po ashtu, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës/Ministria e Arsimit e ka shkëputur këtë kontratë dhe rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses në tërësi të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike civile ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, ekzistimi i marrëdhënies së punës, se paditësja nga data 12.03.2020 deri më 21.11.2022 ka qenë e pranishme në punë 408 ditë dhe se nuk i janë paguar shpenzimet e ushqimit, pasi as e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar, ngaqë gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadija e paditëses.

Meqë baza ligjore e kërkesëpadiës së paditëses mbështetet në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), nenin 245, par. 1, në të cilin është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij” lidhur me nenin 35, par. 7 të KKAK-së, në fuqi nga data 18.04.2017 dhe ajo KKAK në fuqi nga data 21.01.2021, sipas të cilit është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”, gjykata e miratoi në tërësi kërkesëpadinë si në dispozitiv të aktgjykimit sepse, nuk ishte kontestuese që e paditura nuk ia ka paguar paditëses shpenzimet e ushqimit për ditët sa ajo ka qenë në punë.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara pasi kërkesa e paditëses është për periudhën sa kanë qenë në fuqi KKAK e V.t 2017 dhe 2021 ndërsa, palët kontraktuese të KKAK-së Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar:

Numri i lëndës: 2024:015871
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05428238

“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” ndërsa, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate.”

Gjykata, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë çështje kontestimore, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 449 dhe 453 të LPK-së, ashtu që në emër të shpenzimeve për taksë gjyqësore për padi dhe përpilim të padisë, detyroi të paditurën që paditëses t’ia paguajë shumën 125 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.510/2024, datë 07.03.2024

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në P., në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.